



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
**KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI**

Nr. 567/8 prot.

Tiranë, më 07. 08. 2025

**V E N D I M**

**Nr. 180, datë 07. 08. 2025**

Mbështetur në nenin 32, pika 1, shkronja a, të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar<sup>1</sup>, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi<sup>2</sup>, mori në shqyrtim ankesën nr. 78, datë 01.04.2025, e paraqitur nga B. R., kundër Drejtorisë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror (DRSHSSH) Fier në të cilën pretendohet për diskriminim të djalit të tij, G. R., për shkak të “aftësisë së kufizuar”.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri,

**K O N S T A T O I:**

**I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.**

Bazuar në ankesën e paraqitur pranë Komisionerit, B. R., parashtron si vijon: “Unë, B. R., babai i G. R., banues në fshatin Peshtan i Madh, të Qarkut Fier, dëshiroj të paraqes këtë ankesë në emër të djalit tim (PAK) lidhur me një padrejtësi të pësuar për shkak të vonesave burokratike në përpunimin dhe delegimin e dosjes së KEMP-it të djalit.

Sipas Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 736, datë 27.11.2024, të gjithë personat me aftësi të kufizuara (PAK) kanë përfituar një pagesë shtesë (bonus) në muajin dhjetor. Megjithatë, për shkak të vonesës në përpunimin/delegimin e dosjes, pagesa e KEMP-it u ndërpre, duke bërë që të humbas automatikisht të drejtën për këtë bonus.

Për të përfituar shpërblimin prej 150 eurosh të miratuar nga qeveria shqiptare në dhjetor 2024, personat me aftësi të kufizuara (PAK) dhe kategoritë e tjera të përfshira në vendim duhet të

<sup>1</sup> Në vijim do t'i referohemi me shkurtesën LMD.

<sup>2</sup> Në vijim do t'i referohemi me shkurtesën Komisioneri.

*ishin përfitues ekzistues të skemave të mbrojtjes sociale deri në atë periudhë. Ky shpërblim u akordua automatikisht për këto kategori, duke përfshirë familjet në nevojë, fëmijët pa kujdes prindëror dhe kujdestarët e personave me aftësi të kufizuara.*

*Djali im ishte pjesë e skemës në mënyrë të pandërprerë, kjo nënkupton që pagesa e KEMP-it u krye edhe në dhjetor (që ishte kusht për përfitimin e bonusit), po për shkak se Vendimi i biopsikosocial-it postohet me vonesë në Njësinë Administrative Frakull e Madhe nga DRSHSSH-ja (ka mbërritur pas datës 10 dhjetor 2024), u bë shkak në mos përfitimin e bonusit.*

*Dua të theksoj se kjo situatë nuk ka ardhur si pasojë e ndonjë faji apo neglizhence nga ana ime, por ekskluzivisht për shkak të procedurave administrative, të cilat nuk kanë respektuar afatet dhe më kanë penalizuar padrejtësisht. Kjo më ka shkaktuar vështirësi të konsiderueshme financiare dhe ka përberë një trajtim të pabarabartë ndaj meje në krahasim me përfituesit e tjerë të vonesave burokratike në përpunimin dhe delegimin e dosjes së KEMPI-t të djalit.*

*Për këtë arsye, ju kërkoj të ndërhyjni për të garantuar që unë dhe të gjithë personat në situatën time të mos penalizohemi për shkak të vonesave administrative, dhe të na sigurohet e drejta për të marrë bonusin e dhjetorit, ashtu siç është parashikuar nga ligji...”.*

Përfundimisht ankuesi kërkon nga Komisioneri konstatimin e diskriminimit dhe përfitimin e bonusit të dhjetorit si person me aftësi të kufizuara.

## **II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.**

Komisioneri mori në shqyrtim ankesën e sipërcituar, në referencë të kompetencës së parashikuar në nenin 32, pika 1, germa a, të LMD, që i atribuon të drejtën të shqyrtojë ankesat nga personat ose grupet e personave që pretendojnë se janë diskriminuar, sikurse parashikohet në këtë ligj.

LMD, rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit, bazuar në një listë të hapur shkaqesh, por në mënyrë të shprehur neni 1, i ligjit parashikon mbrojtjen nga diskriminimi për shkakun e pretenduar nga pala ankuese, duke përcaktuar se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër.”

Neni 7, i LMD, të ndryshuar, parashikon shprehimisht: “1. Çdo veprim ose mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash, përbën diskriminim. 2. Eliminimi i të gjitha privilegjeve dhe i diskriminimit të padrejtë, garantohet për

*cilindo, në bazë të të drejtave vetjake, politike, ekonomike, shoqërore dhe kulturore të siguruara nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë dhe aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe nga ligjet në fuqi. 3. Autoritetet publike kanë detyrimin për të promovuar barazinë dhe për të parandaluar diskriminimin gjatë ushtrimit të funksioneve të tyre.”*

Në Kreun III, të LMD parashikohet mbrojtje e posaçme nga diskriminimi në fushën e të mirave dhe shërbimeve. Ky ligj në nenin 20, pika 1, të tij parashikon se: *“1. Personi fizik ose juridik që ofron të mira apo shërbime për publikun, me pagesë ose jo, ndalohej të diskriminojë një person tjetër, i cili kërkon t’i arrijë ose t’i përdorë ato: a) duke refuzuar t’i japë një personi apo grupi personash të mira apo shërbime për shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji; b) duke refuzuar t’i ofrojë një personi të mira apo shërbime në mënyrë të ngjashme, ose me cilësi të ngjashme, ose në kushte të ngjashme me ato në të cilat këto të mira apo shërbime i ofrohen publikut në përgjithësi.”*

Pas depozitimit nëpërmjet Zyrës Rajonale të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi në Fier, u konstatua se ajo kishte mangësi të anës formale, lidhur me legjitimitimin si palë në procedurën administrative pranë Komisionerit.

Në vijim të ndjekjes së procedurave ligjore, Komisioneri reflekton mbi vlefshmërinë ligjore dhe të provuar, të shkakut të diskriminimit. Në përfundim, vërteton duke analizuar provat e mbledhura gjatë hetimit administrativ, nëse ka lidhje shkakësore ndërmjet qëndrimit të padrejtë, disfavorizues e të pabarabartë ndaj së cilit subjekti ankues është ekspozuar, me shkakun e diskriminimit të pretenduar.

Në nenin 33/5 të ligjit nr. 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, përcaktohet se: *“Personat fizikë ose juridikë, kundër të cilëve është paraqitur ankesa, njoftohen me shkrim nga Komisioneri brenda 15 ditëve nga marrja e ankesës”*.

Neni 91/3 të Kodit të Procedurës Administrative, të ndryshuar, parashikon se: *“Nëse ligji parashikon detyrimin e palës për të paraqitur dokumente ose prova, si pjesë ose së bashku me kërkesën për fillimin e procedurës, afatet e përcaktuara sipas pikave 1 ose 2, të këtij neni, fillojnë nga paraqitja e plotë e tyre”*.

- Sa më sipër, nëpërmjet komunikimit telefonik, më datë 04.04.2025, nga ana e Drejtorisë së Hetimit Administrativ/KMD, është kontaktuar B. R. dhe i është kërkuar të vërë në dispozicion të Komisionerit një deklaratë përfaqësimi për djalin e tij, shtetasin G. R.. Gjithashtu, është pyetur nëse djali i tij ka humbur zotësinë për të vepruar dhe ai është caktuar përfaqësuesi ligjor, të depozitohet dokumenti përmes së cilit vërtetohet që ai është caktuar përfaqësuesi ligjor i të birit.

- Në vijim, nëpërmjet e-mail-it datë 10.04.2025, G. R. ka depozituar pranë Zyrës Rajonale të KMD-së Fier, një deklaratë përmes së cilës ka autorizuar të atin, B. R., për të ndjekur procedurat e shqyrtimit pranë Komisionerit.

Pas plotësimit të ankesës me të gjithë elementët e saj dhe në zbatim të parashikimeve ligjore, të neneve 32 dhe 33, të LMD, të ndryshuar, Komisioneri ka shqyrtuar çështjen duke ndërmarrë hapat si më poshtë:

1. Me shkresën nr. 567/1 prot., datë 11.04.2025, Komisioneri ka njoftuar dhe kërkuar parashtrime nga Shërbimi Social Shtetëror<sup>3</sup> dhe Drejtoria Rajonale e Shërbimit Social Shtetëror Fier<sup>4</sup>, lidhur me pretendimet e ankuesit.

Në përgjigje përsa më lart, DRSHSSH Fier, përmes shkresës<sup>5</sup> nr. 426/3 prot., datë 22.04.2025 dhe SHSSH përmes shkresës<sup>6</sup> nr. 3235/3 prot., datë 24.04.2025, mbajtën të njëjtin qëndrim duke informuar Komisionerin për Mbrojtjen nga Diskriminimi, lidhur me parashtrimet e tyre sa i përket ankesës së paraqitur nga subjekti ankues, si dhe duke theksuar ndër të tjera se kryerja e pagesave mujore të aftësisë së kufizuar dhe pagesat e bonusit të fundvitit janë në kompetencën e njësive të vetëqeverisjes vendore.

Ndër të tjera, DRSHSSH Fier, informoi Komisionerin se: *“...G. R. ka aplikuar për rikomisionim në dt. 22.11.2024, në dt. 26. 11.2024 është zhvilluar intervista dhe vendimi Nr. AK-2024-036724 për aftësinë e kufizuar ka dalë në datën 01.12.2024 dhe ka përfituar pagesën e aftësisë së kufizuar për periudhën 01.12.2024 - 01.12.2025, në datën 13.12.2024 nr. prot. 1326 është nisur shkresa përcjellëse me vendimin bashkëngjitur, Njesisë Administrative Frakull, Bashkia Fier.*

*Vendimi Nr. 854 “Për mbështetjen financiare për kategoritë e veçanta” ka dalë në datë dt. 26.12.2024 dhe nga komunikimi i realizuar është bërë njoftimi për çdo Bashki, që pagesa do të bëhet mbi listëpagesat e muajit Dhjetor, por gjithmonë duke marrë në konsideratë të gjitha vendimet e gjeneruara gjatë gjithë muajit dhjetor për komisionimin dhe rikomisionimin e aftësisë së kufizuar. Në një korrespondencë të vazhdueshme njoftimesh, ju është komunikuar përfshirja në pagesën e fondit të bonusit të fundvitit duke i rishikuar listëpagesat e gjeneruara. Në raste të veçanta për Njësi Administrative të ndryshme janë alokuar fonde për pagesën e fondit të fundvitit edhe gjatë muajit Janar në mënyrë që çdo qytetar të përfitonte bonusin e fundvitit.*

*Në këto kushte, i është kërkuar Bashkisë Fier një arsyetim se përse qytetari nuk e ka përfituar bonusin e fundvitit. Në përgjigje të saj bashkia komunikon që pagesat e bonusit të fundvitit i ka realizuar në bazën e listëpagesave për muajin dhjetor të cilat i gjeneron brenda datës 10 të çdo muaji dhe çdo vendim i aftësisë së kufizuar që nuk ka shkruar fizikisht në Njësitë Administrative nuk është përfshirë për pagesë në listëpagesat e muajit dhjetor. Pretendimi i qytetarit që nuk ka përfituar nga pagesa e fundviti nga verifikimet rezulton të jetë i drejtë. Jemi përpara faktit që*

<sup>3</sup> Në vijim do ti referohemi me akronimin SHSSH.

<sup>4</sup> Në vijim do ti referohemi me akronimin DRSHSSH Fier.

<sup>5</sup> Protokolluar pranë Komisionerit me nr. 567/2 prot., datë 24.04.2025.

<sup>6</sup> Protokolluar pranë Komisionerit me nr. 567/3 prot., datë 30.04.2025.

*borderot dhe pagesën per aftësinë e kufizuar përfshirë edhe bonusin e fundvitit janë në kompetencë të bashkive.””*

2. Në vijim, përmes shkresës nr. 567/4 prot., datë 30.04.2025, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, iu drejtua Bashkisë Fier dhe Njesisë Administrative Frakull, duke i njohur ata me parashtrimet e DRSHSSH Fier, si dhe kërkuar informacion dhe parashtrime sa i përket pretendimeve të B. R.

Në përgjigje përsa më lart, Bashkia Fier, përmes shkresës<sup>7</sup> nr. 5336/1 prot., datë 09.05.2025, informoi Komisionerin ndër të tjera se: *“...Dosja e G. R., ka qenë për rikomisionim dhe vendimi ka ardhur i protokolluar në Njësinë Frakull më datë 16.12.2024. për Dhjetorin personi në fjalë ka qenë pa pagesë pasi vendimi ka ardhur pasi borderoja ishte hartuar dhe pagesat kishin kaluar në Thesar. Për rrjedhojë në muajin Janar 2025 është bërë pagesa dhe për dhjetorin. Kjo është arsyeja që personi nuk ka përfituar shpërblimin e fundvitit pasi, sipas e-mailit të ardhur nga Drejtoria Rajonale e Shërbimit Social Shtetëror, mbi modalitetet e VKM nr. 854, datë 26.12.2024, sqarohej se shpërblim përfitojnë personat të cilët janë me pagesë në muajin dhjetor.*

*Nga Drejtoria Rajonale e Shërbimit Social Shtetëror nuk kemi marrë asnjë udhëzim apo shkresë zyrtare që pagesat e shpërblimeve të bëhen sipas informacionit elektronik në sistem, por kemi zbatuar korrektësisht VKM nr. 722, datë 11.11.2019, të ndryshuar, Kreu III, pika 5, germa b, në të cilën saktësohet që kryerja e veprimeve financiare për dhënien e pagesës për përfituesit e aftësisë së kufizuar, kryhet pas përcjelljes zyrtarisht në Bashki të vendimit përkatës.*

*Shtojmë këtu, që në fund të muajit Dhjetor, përpara shpërndarjes së shpërblimeve, vetë Drejtoria Rajonale dërgon e-mail, një listë me persona, të cilëve nuk u ishte përcjellë vendimi i Kempit në Bashki. Këto emra u reflektuan në listën e shpërblimeve. Në të njëjtën mënyrë mund të njoftoheshim edhe për çdo vendim tjetër.*

*Sa për sqarim, nga Drejtoria Rajonale nuk kemi pasur asnjë njoftim verbal apo zyrtar që gjatë muajit Janar mund të alokoheshin fonde për pagesa shpërblimesh të pakryera në Dhjetor.*

*Në Bashki hartohen listë-pagesat në bazë të vendimeve ardhur zyrtarisht nga Drejtoria Rajonale, por fondet alokohen si grante të kushtëzuara dhe të dërguara nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit Social Shtetëror përmes Drejtorisë Rajonale.*

*Ka pasur shumë dosje për rikomisionim atë muaj, jo vetëm nga Komisioni Biopsiko-Social por edhe nga Komisionet Eprore apo të Tetraplegjisë, të cilët për të njëjtën arsye nuk kanë përfituar shpërblimin. Kështu që këtu nuk kemi të bëjmë me diskriminim, por me zbatim të udhëzimeve...”*

3. Në këto kushte, për administrimin e plotë të informacionit të kërkuar, për një gjykim sa më të drejtë dhe objektiv të çështjes, si dhe në zbatim të parimit të barazisë për një proces të rregullt ligjor, Komisioneri vlerësoi të nevojshme realizimin e seancës dëgjimore mes palëve. Në këtë kuptim me anë të shkresës nr. 567/6 prot., datë 19.06.2025 “Njoftim për seancë dëgjimore”,

---

<sup>7</sup> Protokolluar pranë Komisionerit me nr. 567/5 prot., datë 12.05.2025.

Komisioneri njoftoi Bashkinë Fier, Shërbimin Social Shtetëror dhe Drejtorinë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror Fier lidhur me zhvillimin e seancës dëgjimore më datë 02.07.2025.

Bazuar në nenin 80/1/b të Kodit të Procedurave Administrative dhe Rregullores së Brendshme të Komisionerit, seanca dëgjimore u regjistrua audio dhe përmbajtja e saj do të përdoret si provë gjatë procesit të shqyrtimit të ankesës.

Seanca u zhvillua në datë 02.07.2025, me praninë e: palëve kundër të cilave është paraqitur ankesa, përfaqësueseve me autorizim të SHSSH-së dhe DRSHSSH-së Fier, si dhe Bashkisë Fier. Ndërsa pala ankuese nuk u paraqit në seancën e zhvilluar.

Gjatë seancës dëgjimore, palët iu qëndruan të njëjtave parashtrime që kishin bërë të njohura gjatë komunikimit shkresor me KMD-në.

Ndër të tjera, gjatë seancës nga ana e përfaqësueses së Bashkisë Fier u theksua se në muajin pasardhës, në momentin që do të hartoheshin listë-pagesat e aftësisë së kufizuar, G. R., do t'i bëhej edhe kalimi i pagesës së prapambetur të shpërblimit të fundvitit, për të cilin ankuesi ka paraqitur pretendimet për diskriminim.

- Në vijim, më datë 07.08.2025, ankuesi B. R., ka depozituar pranë Zyrës Rajonale të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, në Fier, kërkesën për tërheqjen nga shqyrtimi i mëtejshëm i ankesës, për shkak se djali i tij, G. R., kishte përfituar pagesën e prapambetur, të shpërblimit të fundvitit.

Sa më sipër Komisioneri vlerëson se, kërkimi i palës ankuese, ose ajo që pala ankuese kërkon të arrijë ose të sigurojë, nëpërmjet paraqitjes së ankesës objekt shqyrtimi dhe fillimit të kësaj procedure administrative është përmbushur, nëpërmjet përfitimit të pagesës së prapambetur, të shpërblimit të fundvitit 2024, nga ana e Bashkisë Fier. Për këtë qëllim, subjekti ankues, ka paraqitur kërkesë për tërheqjen nga shqyrtimi i mëtejshëm i ankesës për shkak se ishte arritur qëllimi dhe efektiviteti për të cilin kishte paraqitur ankesën nr. 78, datë 01.04.2025.

Në këto kushte, Komisioneri vlerëson se qëllimi për të cilin ishte filluar hetimi administrativ është përmbushur në thelb, dhe në referencë të nenit 33, pika 9, të ligjit 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, ku parashikohet se: *“Kur e sheh të përshtatshme, Komisioneri kërkon të arrijë marrëveshje pajtimi mes ankuesit dhe personit kundër së cilit është paraqitur ankesa”*, KMD vlerëson se është arritur efektiviteti dhe qëllimi për të cilin ishte iniciuar ankesa.

Në nenin 90/3 të ligjit nr. 44/2015 *“Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”* parashikohet përfundimi i procedurës administrative: *“Procedura administrative, e nisur me kërkesë apo kryesisht, deklarohet e përfunduar pa një vendim përfundimtar për çështjen, në rastet e parashikuara në nenet 93-96 të këtij Kodi. Deklarata e përfundimit të procedurës administrative, pa një vendim përfundimtar për çështjen, përbën akt administrativ”*.

Njëkohësisht, në referencë të nenit 94/1, të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, i cili parashikon se: “Si rregull, në procedurën administrative të nisur me kërkesë, organi publik deklaron përfundimin e saj pa një vendim përfundimtar për çështjen, nëse pala që ka paraqitur kërkesën e tërheq atë”, Komisioneri deklaron përfundimin e saj pa një vendim përfundimtar.

### **PËR KËTO ARSYE:**

Mbështetur në nenin 90/3 dhe 94/1, të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, dhe nenet 32 e 33, të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

### **V E N D O S I:**

1. Të deklarojë të përfunduar procedurën administrative për shqyrtimin e ankesës nr. 78, datë 01.04.2025, të B. R., në cilësinë e përfaqësuesit të djalit të tij, shtetasit G. R., pasi është arritur efektiviteti dhe qëllimi, për të cilin ka filluar procedura administrative.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni.

**KOMISIONERI**

**Robert GAJDA**

(Shkaku: Aftësi e kufizuar)

(Fusha: Të mira dhe shërbime)